

**Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 1**

**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

[27.09.2023]

Drejtuar: **BOE: NIEM Shpk me Nipt: K36609610Q Adresë: Korce, Autostrada Bilisht Korce, Km. i 3, Bitincke & UDHA Shpk me NIPT K77524909Q Adresa: Diber Burrel Lagjia Pjeter Budi.**

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedure e Hapur-Pune**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF - 74887-07-12-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti: **Mbrojtje nga ujerat e larta dhe sistemimi i perroit te SMT**

Kohëzgjatja e kontratës: **6 (gjashte) muaj nga njoftimi i fillimit te punimeve.**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [62] [17.07.2023]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. BOE ARTYKA II Shpk K26625603U & ERGI SHPK K02727229P**

Vlera: 37,207,254 ( tridhjetë e shtatë milion e dyqind e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa tvsh

**2. BOE ASI-2A CO Shpk K53002402C & SHENDELLI Shpk K07924803N**

Vlera: 37,478,868 (tridhjetë e shtatë milion e katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë)lekë pa tvsh

**3. AVDULI Shpk J66703306O**

Vlera: 35,630,375 (tridhjetë e pesëmilion e e gjashtëqind e tridhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh

**4. BOE Desaret Company Shpk K01816001J & FLED Shpk K17621104C & “Aurora Konstruksion” Shpk K02017002I**

Vlera: 29, 490, 619.20 (njëzet e nëntë milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë pikë njëzet) lekë pa tvsh

---

<sup>1</sup> Ky Formular është i aplikueshëm nëse ka Ankime

**5. L.T.E CONSTRUCTION Shpk****L78006801F**

Vlera: 29,889,185 (njëzet e nëntë milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh

**6. BOE: NIEM Shpk K36609610Q & UDHA Shpk K77524909Q**

Vlera: 35, 690, 533 (tridhjetë e pesë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh

**7. S.M.O UNION Shpk****J66902042Q**

Vlera: 36, 560, 969 (tridhjetë e gjashtë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1. BOE Desaret Company Shpk K01816001J & FLED Shpk K17621104C & "Aurora Konstruksion" Shpk K02017002I****Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

-Oferta e paraqitur nga BOE - "DESARET COMPANY" SHPK & "FLED" SHPK & "AURORA KONSTRUKSION" SHPK me vlere 29,490,619.20 Leke pa Tvsh, eshte vleresuar nga KVO si oferte anomalisht te ulet, sipas dispozitave te nenit 82 pika 4 e VKM 285 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".

Ne keto kushte, KVO bazuar ne nenin 93 te LPP I cili parashikon shprehimisht se.....Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për: .

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

KVO ne daten 22.08.2023 nepermjet Sistemit te Prokurimit Elektronik te APP i ka kerkuar BOE - "DESARET COMPANY" SHPK & "FLED" SHPK & "AURORA KONSTRUKSION" SHPK te paraqese me shkrim brenda 3 diteve pune, shpjegime per elementet te ofertes sipas parashikimeve te siperpermendura.

BOE - "DESARET COMPANY" SHPK & "FLED" SHPK & "AURORA KONSTRUKSION" SHPK ne daten 24.08.2023 nepermjet Sistemit te Prokurimit Elektronik te APP me shkresen Nr.19 Prot. Date 24.08.2023 ka paraqitur dokumentat me arsyetimet perkatese per oferten anomalisht te ulet.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave pas shqyrtimit te dokumentacionit paraqitur nga BOE - "DESARET COMPANY" SHPK & "FLED" SHPK & "AURORA KONSTRUKSION" SHPK per oferten anomalisht

te ulet, arsyeton si me poshte vijon; .

BOE - "DESARET COMPANY" SHPK & "FLED" SHPK & "AURORA KONSTRUKSION" SHPK ne kthim pergjigjen per arsyetimin e ofertes anomalisht te ulet, nuk ka argumentuar elementet e parashikuara ne nenin 93, te sipercituar.

## 2. AVDULI Shpk

**J66703306O**

### **Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

Bazuar në parashikimet e Rr.P.P. miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku konkretisht në pikën 6, të nenit 26, parashikohet:

- Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...

Përsa më sipër, ofertuesi i kualifikuar OE "AVDULI" SHPK ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor Bashkia Devoll dokumentacionin, e parashikuara në pikën 6, të nenit 26, të Rr.P.P., brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit paraprak, sipas nenit 97/1, të LPP-së.

Ne parashikimet e pikes 7. të nenit 26, të Rr.P.P., Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

-Në rastin konkret AK gjykon se OE - "AVDULI" SHPK nuk ka përmbushur kerkesat e DST ne kete procedure prokurimi, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, nuk zotëron kapacitetet teknike , makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, per realizimin me sukses të kontratës.

## 3. L.T.E CONSTRUCTION Shpk

**L78006801F**

### **Perkatësisht për arsyet e mëposhtme"**

OE - "L.T.E CONSTRUCTION" SHPK nuk përmbush kerkesat e pikes 2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- N.P - 1 A Punime gjurmimi në tokë;
- N.P - 7 A Ujsjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.
- NP – 9 B Punime per mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime
- NP 12 – A Punime të inxhinierisë së mjedisit

Për punimet speciale të ndërtimit :

- NS – 18 A Punime topogjeodezike

\*Pasi Licenca NZ.7553/6 per kategorine NP-9 ka klasifikim A

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE: NIEM Shpk me Nipt: K36609610Q Adresë: Korce, Autostrada Bilisht Korce, Km. i 3, Bitincke & UDHA Shpk me NIPT K77524909Q Adresa: Diber Burrel Lagjia Pjeter Budi**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **35, 690, 533 (tridhjetë e pesë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë pranë [Autoritetit Kontraktor, Bashkia Devoll Adresa: Lagjia Nr. 1 Rruga. "24 Tetori" Bilisht] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JOX

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO  JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

**[TITULLARI I AUTORITETIT /ENTIT KONTRAKTOR]**

**EDUARD DURO**

